



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.03.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 13.03.2017 dhe 15.03.2017.

2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””. *(komision përgjegjës)*

3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë””. *(komision përgjegjës)*.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Luan Rama, Anila Agalliu, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Tom Doshi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Edmond Leka, Tahir Muhedini, Silva Caka, Mhill Fufi, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia, Adelina Rista, Luljeta Arapi, Shkëlqim Troplini.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Arben Ristani, Eduard Halimi, Fatmir Mediu, Nard Ndoka dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Artan Hoxha - ekspert

Henrik Ligori - ekspert

Arben Rakipi - ekspert

Korajlka Bumçi – përfaqësuese e Euralius-it

Jon Smibert – përfaqësues i OPDAT-it

Katrin Treska - Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Edlira Bako - Drejtore e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore) në Ministrinë e Drejtësisë

Denisa Hasko - Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore) në Ministrinë e Drejtësisë

Bledar Dervishaj - Kabineti i Ministrit

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorumi është bërë i plotë. Në rendin e ditës kemi disa pika, duke filluar nga miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 13.03.2017 dhe 15.03.2017, të cilat jua ka dërguar Edlira me *e-mail*.

A keni ndonjë vërejtje? Jo.

Dakord.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””. Relatorët zoti Manja dhe zoti Muçmataj janë gati për projektin. Ekspertët që kanë punuar me projektin, si dhe përfaqësuesit e ministrisë, gjithashtu, janë të pranishëm, kështu që mund të vazhdojmë.

Atëherë, zoti Rakipi dhe zoti Manja në rregull, të fillojmë? Po.

Pra, kemi shqyrtuar dhe kemi votuar në parim projektin kështu që vazhdojmë.

Neni 1. A ka ndonjë gjë? Jo.

Dakord.

Neni 2. Dakord.

Neni 3. Dakord.

Neni 4. Dakord.

Neni 5. Dakord.

Neni 6. Dakord.

Neni 7.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me nenin 7 në paragrafin e dytë ne bëjmë përjashtime bazuar në nene konkrete. Në fakt, në praktikën tonë hera-herës Kodi Penal pëson ndryshime, ka nene të reja të shtuara ose të hequra. A nuk do të ishte më mirë që përjashtimi i të dënuarit nga përfitimi të bëhet jo në bazë të neneve konkrete, por në bazë të rrezikshmërisë së veprës, të faktit për shembull nëse autori ose i dënuari është përsëritës apo jo? Pra, të jetë pak më i përgjithshëm përjashtimi, për shembull, për 78/a, 79/a, b, c e të tjerë ku autorë mund të jetë një grua, mund të jetë një i mitur dhe nuk i mban

parasysh rrethanat e tjera në të cilat mund të jetë kryer një vepër penale, nuk është as humane dhe nuk është as në funksion të qëllimit që ndjek qoftë dënimi apo ulja e dënimit, lirimi me kusht e të tjera.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Edhe unë do të shtoja diçka, sepse është i nevojshëm dëgjimi i disa argumenteve shtesë lidhur me paragrafin e dytë që ju kërkoni të ndryshoni “jo më pak se 25 vjet” me “jo më pak se 35 vjet”. Pra, cilat janë argumentet që ju çojnë në këtë ndryshim?

Kush do të përgjigjet për këtë?

Zoti Rakipi.

Arben Rakipi – Ne e kemi mbështetur idenë që personat që kryejnë vepra penale të dhunshme të mos përfitojnë lirim para kohe me kusht. Gjithashtu, kemi përshtypjen se siguria publike cenohet rëndë nga qarkullimi i tyre. E para.

E dyta, për shkak të një mospërputhjeje të procesit të edukimit nëpër burgje me atë që lirimi para kohe me kusht përmban në thelb themi se dhënia e një bonusi të tillë është fiktive. Ne kemi gjykuar se bëhet pak për riintegrimin dhe edukimin e personave të dënuar për krime të rënda në burg. Procesi edukativ dhe rikuperues i tyre atje është i pamjaftueshëm dhe mbështetja në elemente të tilla të përgjithshme, si ato që përmban dispozita përkatëse, si është arritur qëllimi i edukimit të tij apo nëse ai ka sjellje shembullore, janë elemente fiktive, ashtu siç e ka hasur shpesh praktika gjyqësore në këtë vend.

Po kthehem tani te pika e parë që është edhe më e rëndësishmja. Ne jemi dëshmitarë, të paktën ne që kemi shënuar paragrafin në fjalë, se si persona të cilët kanë kryer vepra penale të rënda, të rrezikshme, disa vrasje, janë kthyer menjëherë nëpërmjet këtij mekanizmi në qarkullimin civil, pra nëpërmjet mekanizmit që unë sapo e përmenda. Interesi primar për ne, nuk po them: “për mua”, por po them: “për ne”, është interesi publik dhe rëndësia që publiku të rrijë i qetë për faktin se nuk do të ketë pas një kohe relativisht të pakët, persona të tillë që të qarkullojnë përsëri pranë tij. Nuk është një çështje, si të thuash, e mbështetur mbi standarde të matshme, është një çështje thjesht interpretimi që e ka bazën më të madhe të interpretimit e ka te siguria publike.

Fatmir Xhafaj – A ka komente të tjera? A jeni të qartë për këtë?

Dakord.

Neni 8.

Arben Rakipi - Për nenin 8, kështu siç është formuluar, nuk kam kundërshtim, veçse në variantin e parë që kemi kaluar në parim është bërë një dallim lidhur me masat dyshme dhe tavan të dënimit, siç është fjala “15 vjet e 1 ditë”, “10 vjet e 1 ditë”. Kjo ka rëndësi, sepse nga njëri paragraf në tjetrin ka dallime ose përputhje në këto dispozita dhe praktika shpeshherë ka qenë e paqartë se cilin paragraf do të zbatojë.

Kështu që do të propozoja që germa “a” e nenit të ketë në fuqi, 40 vjet në, rastet e krimeve që parashikojnë burgim të përjetshëm dhe pastaj pjesa më poshtë e dispozitës duhet të ruhet formulimi që kemi pasur në variantin e miratuar në parim, sepse ka elementin “10 vjet e 1 ditë”, “15 vjet e 1 ditë”, për të bërë dallimin nga njëri paragraf në tjetrin.

Fatmir Xhafaj – Relatorët?

Kjo që propozohet sa e zgjidh keqkuptimin? Sot në praktikë kemi realisht një keqkuptim, sa e zgjidh ky propozim?

Ulsi Manja- Ne e kemi diskutuar këtë me kolegun Muçmataj. Legjislacioni ynë nuk ndjek një teknikë të tillë legjislative të përcaktimit të afateve me 10 vjet e 1 ditë edhe pse parimisht bie dakord që në praktikë ka pasur dhe vazhdon të ketë një diskutim lidhur me afatet e parashkrimit, qoftë të ndjekjes penale, qoftë të ekzekutimit të dënimit, kur kemi të bëjmë me dënime që janë në kufirin ndarës të afateve që parashikojnë nenet 66 dhe 68 i “Parashkrimit të ekzekutimit të dënimit”. Gjithsesi, ne kemi qëndruar në variantin ekzistues, sepse tashmë ka praktikë gjyqësore, ka disa vendime të kësaj natyre që i kanë dhënë zgjidhje si interpretohet masa e dënimit që është në kufirin ndarës.

Fatmir Xhafaj – Unë besoj se vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë mund të sqarojnë të jetë e qartë për praktikën që të mos bëjmë një përjashtim nga teknika.

Arben Rakipi- Personalisht unë e kam të qartë.

Fatmir Xhafaj – Po nuk bëhet fjalë për ju, bëhet fjalë për ata që do ta zbatojnë. Ju i keni pasur të dyja rastet të jeni edhe profesori Magjistraturës, siç jeni, edhe njeri i praktikës.

Arben Rakipi - Nga shkolla nisem për atë që thashë se shpeshherë kufiri ndarës ka shërbyer për një debat shumë të madh, nëse gjykata do të zbatojë germën “a” ose germën “b”. Bëhet fjalë sidomos për vepra penale që dënohen deri në 10 vjet. Është thënë që ky dënim deri në 10 vjet është kufiri maksimal ose minimal. Logjika e gjërave e sqaron situatën, por thjesht për të eliminuar atë debat praktik dhe shpesh vendime gjyqësore të dhëna në kundërshtim me këtë logjikë, unë kam qenë i idesë që ta sqarojmë edhe 1 vit. Nëse teknikisht gjykoni se është e pa....

Fatmir Xhafaj – Ta ezaurojmë këtë? Të zgjidhim një çështje, që të mos i mbivendosim çështjet mbi njëra- tjetrën.

Përfaqësuesit e ministrisë a kanë ndonjë koment për këtë çështje?

Jeni dakord me nenin 8.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Unë, zoti kryetar, kam një çështje për sa i përket teknikës legjislative. Si rregull ne shtojmë ose heqim një shkronjë, por renditja e shkronjave paraardhëse ose pasardhëse nuk lejohet të ndryshojnë. Unë do të doja të dija, pse ekspertët kanë bërë këtë lloj kalimi të renditjes së shkronjës?

Fatmir Xhafaj – Ata kanë riformatuar dispozitën.

Vasilika Hysi – Nëse është formatuar dispozita, është më mirë të jepet e riformatuar në total, pasi ata kanë ndërhyrë në çdo paragraf, në çdo shkronjë të kësaj dispozite, dhe për efekt të kuptimit të ndryshimit të bërë është bashkimi

Fatmir Xhafaj – Pra, edhe një herë shtohet një germë “a” e re dhe zhvendosen të tjerat.

Vasilika Hysi – Nuk lejohet. Ajo bëhet “a/1”. Nuk lejohet spostimi i të tjerave.

Fatmir Xhafaj – Po mirë ta vënë dispozitë të plotë dhe njësoj është.

Vasilika Hysi – Të bëhet një dispozitë e plotë e riformuluar.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

A është dakord ministria?

Ulsi Manja - Dakord.

Bledar Dervishaj – Në propozimin që kemi bërë ne është riformuluar totalisht dispozita, por, edhe kështu në këtë variant, qëndron dispozita.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë kështu mendoj, por ju e dini se jeni ekspertë të fushës, bashkë me ekspertët e tjerë.

Dakord me nenin 8.

Neni 9?

Xhemal Qefalia- Neni 9 dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 10.

Dakord.

Neni 11.

Arben Rakipi – Te neni 11 dhe neni 12 është shtuar një shprehje: “duke marrë parasysh rrethanat dhe motivet e veprës”, them se kjo duhet hequr, sepse bie ndesh pastaj me tërë frymën e dispozitës dhe të Kodit të të Miturve. Së pari, është e paqartë, për çfarë bëhet fjalë, hyn një gjë parimore.

Së dyti, e kushtëzon aplikimin e dispozitës në kundërshtim me ligjin ose me Kodin e të Miturve, kështu që kjo nuk shkon.

Fatmir Xhafaj – Pse nuk e lëmë thjesht: “Në rastet kur veprimi parashikohet në paragrafin e parë të kryer nga një i mitur, ndaj tij do të zbatohet dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur” dhe mbaron këtu. Rrethanat i mbajmë parasysh, sepse duket si fjali politikani pastaj.

Arben Rakipi - Rrethanat nuk mund të mbahen parasysh.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me ndryshimet e neneve 11 dhe 12?

Dakord.

Neni 13.

Dakord.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në diskutimin në parim të këtij kodi, unë, por njëkohësisht edhe përfaqësuesja e EURALIUS- it, zonja Bumçi, ngritëm një shqetësim lidhur me nevojën për qartësimin e krimeve të urrejtjes, në disa dispozita të Kodit Penal. Në vitin 2013 me ligjin nr. 144 ne kemi amenduar nenin 50, germën “j” dhe kemi zgjeruar bazën mbi të cilën një kategori krimesh që kryhen për shkak të racës, gjuhës, besimit, nacionalitetit, etnisë, orientimit seksual, konsiderohen krime në rrethana rënduese, por këtu kemi harruar gjuhën dhe shtetësinë. Pra, në bazë të këtij riformulimi në kod, ne nuk mbrojmë shtetasit që kanë një shtetësi tjetër nga shtetësia shqiptare ose që kanë një gjuhë tjetër. Konkretisht, mospërputhja midis bazës në nenin 50 germa “j” me rregullimet që janë bërë në nenet 119 “b”, 265 /1 dhe 268/2 që është nxitja e urrejtjes bën që..

Fatmir Xhafaj Nuk e ka pasur këtë qëllim dispozita besoj.

Vasilika Hysi - Jo, ai ka qenë qëllimi i dispozitës, ka qenë të rregullohen krimet e urrejtjes. Pra, nuk i kemi replikuar këto rregulla të parashikuara në dispozita e përgjithshme në nenet specifike. Sot jemi në situatën që, kur flasim për nxitjen e urrejtjes, nxitjen e diskriminimit, ne nuk e dënojmë në rrjetet sociale apo në forma të tjera. Gjithashtu, në veprat penale, 265, 266 “Nxitja e urrejtjes”, ne duhet të shtojmë edhe fjalën e diskriminimit dhe duhet të dënojmë jo vetëm në formën e pikturave etj., por edhe nxitjen verbale. E them këtë, sepse kjo kërkesë i është shtruar disa herë

shtetit shqiptar në raportet e Komisionit European kundër racizmit dhe intolerancës dhe është lënë si detyrë që në kuadër të reformës në drejtësi të ndërmarrë në vitin 2014 që Shqipëria brenda dy vjetëve të përmbushë edhe këtë rregull, saktësim të terminologjisë që gjithçka që thuhet në pjesën e përgjithshme për bazën e mosdiskriminimit, të gjejnë pasqyrim në dispozitat përkatëse. Këtu nuk ka draftim të ri të dispozitave, por ka plotësim të elementeve të veçanta të një fjale ose të një togfjalëshi në veprat që unë citova, te nenet 119/b, 120, 265...

Fatmir Xhafaj - Do t'u hyjmë të gjitha këtyre ne?

Vasilika Hysi – Jo janë fjalë të vogla dhe riformulimin e ka sjellë zonja Bumçi...

Fatmir Xhafaj - Dakord pra, por nuk do të shikojmë gjithë Kodin Penal me të gjitha elementet. Në qoftë se kemi gjë për nenin 13, jam dakord. Në qoftë se nuk keni...

Vasilika Hysi – Të nenit 265, jo.

Fatmir Xhafaj - Kur të bëhet që të vijë Kodi Penal le ta rishikojnë.

Vasilika Hysi – Për të shtuar një togfjalësh...

Fatmir Xhafaj – Po dakord, edhe ata kërkojnë një togfjalësh, edhe këta...

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu nuk shtohen nene.

Fatmir Xhafaj – Dakord jam unë, por keni mbajtur një qëndrim në parim dhe nuk do të hyjmë nen për nen.

Vasilika Hysi – Nga ana tjetër, në kuadër të luftës kundër radikalizmit, ekstremizmit, kur ne kemi një strategji të miratuar nga Këshilli i Ministrave për të parandaluar fenomene të tilla, do të ishte shumë mirë që ta përmbushnim edhe këtë detyrim.

Fatmir Xhafaj – Këshilli i Ministrave po e çmoi të arsyeshme, le ta sjellë me shkrim propozimin. Në qoftë se ka strategji, të shikojë strategjitë e veta, t'i sjellë, ja ku është Ministria e Drejtësisë, i propozon, i sjell dhe i miraton në komision.

Neni 13.

Dakord! Faleminderit!

Neni 14.

Dakord!

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet!

Faleminderit!

Mbyllet Kodi Penal.

Faleminderit për kontributin, zoti Rakipi për pjesën tuaj për Kodin Penal!

Faleminderit edhe kolegëve të tjerë që kanë punuar me ju!

Faleminderit për bashkëpunimin edhe përfaqësuesve të ministrisë!

Faleminderit edhe relatorëve për punën e bërë në këtë proces!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.03.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”. (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Luan Rama, Anila Agalliu, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Tom Doshi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Edmond Leka, Tahir Muhedini, Silva Caka, Mhill Fufi, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia, Adelina Rista, Luljeta Arapi, Shkëlqim Troplini.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Arben Ristani, Eduard Halimi, Fatmir Mediu, Nard Ndoka dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Artan Hoxha - ekspert

Henrik Ligori - ekspert

Arben Rakipi - ekspert

Korajlka Bumçi – përfaqësuese e Euralius-it

Jon Smibert – përfaqësues i OPDAT-it

Katrin Treska - Drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Edlira Bako - Drejtore e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore) në Ministrinë e Drejtësisë

Denisa Hasko - Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore) në Ministrinë e Drejtësisë

Bledar Dervishaj – përfaqësues nga Kabineti i Ministrit

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës “Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale”.

Ekspertët kanë punuar dhe janë dakordësuar, besoj, tani është momenti për t’i kaluar nen për nen dhe këtu do të më ndihmojë zoti Manja.

Jeni dakord për nenin 8?

Dakord!

Neni tjetër është neni 41, apo jo, por që rregullon nenin 58?

Dakord!

Artan Hoxha - Këtu kemi pasur parasysh vërejtjeve që ka bërë OPDAT-i dhe është plotësuar dispozita që është propozuar nga OPDAT-i.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 141.

Dakord!

Neni 142.

Dakord!

Neni 143.

Dakord!

Neni 144.

Dakord!

Neni 145, i ri që është shtuar.

Dakord!

Neni 146.

Dakord!

Neni 147.

Dakord!

Neni 148.

Dakord!

Neni 149.

Dakord!

Neni 185.

Dakord!

Neni 186.

Dakord!

Neni 187.

Dakord!

Neni 197 që ndryshon 351 “Mosparaqitja ose largimi i vullnetshëm i të pandehurit”.

Dakord!

Neni 198 “Gjykimi në mungesë”.

Dakord!

Neni 208.

Dakord!

Neni 209.

Dakord!

Neni 210.

Dakord!

Neni 211.

Dakord!

Neni 212.

Dakord!

Neni 213.

Dakord!

Neni 237.

Dakord!

Neni 238.

Dakord!

Neni 239.

Dakord!

Neni 240.

Dakord!

Neni 241.

Dakord!

Neni 242.

Dakord!

Neni 263.

Dakord!

Neni 264.

Dakord!

Neni 265.

Dakord!

Neni 266.

Dakord!

Neni 267.

Dakord!

Neni 268.

Dakord!

Neni 269.

Dakord!

Neni 270.

Dakord!

Neni 271.

Dakord!

Neni 279.

Dakord!

Neni 280.

Dakord!

Neni 281.

Dakord!

Neni 282.

Dakord!

Neni 283 “Dispozita kalimtare”.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, s’ka mbaruar. Jeni dakord?

Mbylleni mikrofonin që t’i jepet mundësia zotit Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Në lidhje me diskutimet e djeshme, nuk i shikojmë të zbardhura ato dy momentet tona.

Fatmir Xhafaj - Të kujt?

Bledar Dervishaj - Të dëshmitarit anonim, apo konsiderohen të dakordësuara që dje dhe nuk janë prekur këtu?

Fatmir Xhafaj – Ta mbyllim me dispozitën kalimtare. Ka ndonjë gjë për dispozitën kalimtare? Ministria ka gjë për dispozitën kalimtare? Do biem dakord për datën 1 gusht për të hyrë në fuqi? Mos është afër si datë?

Bledar Dervishaj – Ne e kemi dakordësuar datën e hyrjes në fuqi dje për datën 1 gusht 2017.

Fatmir Xhafaj -Edhe ministria? Është e mundshme kjo për trajnimin, për të gjitha? A përballohet?

Bledar Dervishaj – Vetë kodi në vitin 1994, kur ka hyrë në fuqi, e kishte 6 muaj që ishte lënë. Kështu që ndryshimet ne menduam se 4 muaj janë të mjaftueshme.

Fatmir Xhafaj – Dakord, ju e dini.

Bledar Dervishaj – Data 1 shtator ishte një variant tjetër. Ministria e Drejtësisë ka qenë për datën 1 shtator, por dje u dakordësua për datën 1 gusht.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord për dispozitën kalimtare.

Ta lëmë ministrinë se cilat ishin problemet tuaja, zoti Dervishaj, para se ta votojmë në tërësi.

Bledar Dervishaj – Ato diskutime që u lanë për nene të hapura, dje ishte neni 165 i projektit.

Fatmir Xhafaj – T'i marrim me radhë. Neni 165.

Bledar Dervishaj – Neni 165/a, që fliste për rolin e dëshmitarit anonim, dhe veprat penale për të cilat ai do të dëshmonte, ne nuk e kemi te drafti këtu.

Dhe i dyti ka të bëjë me urdhrin penal dhe propozimet që ne kishim kryer.

Fatmir Xhafaj – Cili është kapitulli i urdhrit penal?

Bledar Dervishaj – Është neni 226 i projektaktit. Katër dispozita janë ato.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha -Kemi rënë dakord për këtë, por nuk e di nëse është çështje e variantit të parë apo jo, por e kemi lënë për nenin 165/a që dëshmitari anonim të jetë vetëm për veprat penale kundër terrorizmit.

Fatmir Xhafaj – A është dakord dhe ministria me këtë gjë? Dakord. Neni 226/a. Urdhri penal.

Artan Hoxha – Për urdhrin penal këtu ne kemi gjetur një zgjidhje të mesit e cila është për të rënë dakord. Në nenin 406/a në paragrafin 4 kemi shtuar fjalinë që kërkesa për miratimin e urdhrin penal i njoftohet të pandehurit. Më tej pastaj rregullimi mbetet ai që ka qenë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Dervishaj.

Bledar Dervishaj – Këtu është dallimi. Jo, nuk kemi rënë dakord. Për pjesën e propozimit të grupit të ekspertëve e çmoj me vend. Që ky urdhër penal i njoftohet të pandehurit, por dhe i pandehuri duhet që të shprehet në lidhje me këtë para prokurorit ose të gjykatës.

Fatmir Xhafaj – Çfarë problemi ka?

Bledar Dervishaj – Duke i thënë gjykatës që unë jam dakord ta ndjek këtë procedurë, ose nuk jam dakord, dhe dua t'i nënshtrohem gjykimit të zakonshëm. Pra, mos të gjykohet i pandehuri pa u shprehur në lidhje me atë që i është ngritur si akuzë. Në vlerësimin, në propozimin tonë, është që gjykata... Në qoftë se i pandehuri nuk zgjedh këtë rrugë, atëherë gjykata automatikisht duhet ta kalojë në gjykim në normal, sepse ai jo se nuk e pranon... Domethënë ka dy mënyra që nuk e pranon. Ose nuk e pranon për shkak të vlerës së masës së gjobës që i është ngarkuar, ose nuk e pranon fare fajësinë. Dhe kur ai nuk zgjedh ta zbatojë këtë procedurë, që është shumë e mirë për të, që ka 100 benefite, qoftë për sa i përket kohës së gjykimit, masës së dënimit, mosshënimit në regjistrin e ...

Fatmir Xhafaj – Cila është pasoja që krijohet nga kjo ndërhyrje?

Bledar Dervishaj – Ne nuk ramë dakord me këtë pjesë, sepse thuhet që argumentohet nga ekspertët që ruhet në formën e paraqitur. Është edhe zhdërvjellshmëria e gjykimit, apo eficienta në gjykim. Ndërkohë në vlerësimin tonë është që sado nxitojmë duke i kërkuar gjykatës...

Fatmir Xhafaj - Ai njoftohet. Këta bien dakord që të njoftohet. Kurse ajo që thoni ju është se jo vetëm njoftohet, por ai duhet të shprehet. Nuk shprehet me memo.

Bledar Dervishaj - Mund t'i shprehet gjykatës me shkrim, sepse gjykimi zhvillohet në mungesë. Kjo është risia dhe për këtë ne biem dakord. Nuk ka asgjë të keqe. Por të paktën ai le të

shprehet qoftë në seancën e fundit që prokurori i komunikon akuzën. Dhe aty nëse ai nuk shpreh dakordësinë është e kotë që të shkohet me urdhër penal.

Fatmir Xhafaj – Zonja Bumçi bie dakord.

Ulsi Manja – Për urdhrin penal edhe dje ndërmjet grupit të punës ka pasur diskutime. Personalisht në variantin siç propozohet nga Ministria e Drejtësisë, pavarësisht se me kolegun Muçmata ndajmë mendime të ndryshme, unë kam propozuar që urdhri penal të hiqet komplet nga projekti për dy arsye.

Fatmir Xhafaj – Ajo është një gjë shumë e mirë për ta nisur procesin.

Ulsi Manja – Qëllimi kryesor i urdhrin penal është ekonomia gjyqësore. Por në rast se në variantin që propozohet përpos dijenisë që do të marrë i pandehuri lidhur me urdhrin penal, në përfundim të hetimeve, gjykimi pa praninë e palëve e ndërlikon këtë proces. E para.

Fatmir Xhafaj – I jep njoftimin dhe ti i lë një afat të shprehet për këtë?

Ulsi Manja – E dyta, ka një problem më madhor.

Fatmir Xhafaj – I lë një afat, nuk e thërret në seancë. I thua njoftimin. Në qoftë se brenda 10 ditëve ai nuk...

Ulsi Manja – Në vlerësimin tim ka një problem tjetër që lidhet me prokurorin. Duke qenë urdhri penal diskrecion i prokurorit kjo nesër do të kthehet në një lloj “abuzimi”, sepse është çështje e vlerësimit të prokurorit që njërin ta çojë me urdhër penal dhe tjetrin me gjykim të zakonshëm. Ndërkohë që prokurorit nuk mund t’i thuash në dispozitë në mënyrë taksative që të gjitha çështjet ose të gjithë personat që akuzohen për kundërvajtje penale të shkojnë me urdhër penal. Këtë nuk e thua dot, sepse e ndalon Kushtetuta, neni 141 i Kushtetutës. Prokurori është i pavarur në ushtrimin e funksionit të ndjekjes penale dhe të hetimit. Nesër do të na kthehet që një pjesë të të pandehurve, prokurori do të disponojë t’i çojë nëpërmjet urdhrin penal. Një pjesë tjetër do t’i çojë me gjykim të zakonshëm. Dhe këtu humbet parimi i garancive të të pandehurit në procesin penal. Kjo ka qenë arsyeja që në mënyrën se si propozohet kjo duhet hequr.

Henrik Ligori – Unë mendoj se duhet sqaruar problemi i urdhrin penal, se më duket që për këtë histori është ngritur një furtunë në gotë. Urdhri penal është i domosdoshëm. Për dijeninë e të nderuarit deputet kjo është një procedurë shumë e thjeshtë, gati administrative. Bëhet fjalë për kundërvajtje penale. Në qoftë se prokurori ndodhet para një kundërvajtjeje penale dhe çmon që personin e akuzuar nuk duhet ta dënojë me burgim, por me gjobë. Bën një urdhër dhe i cakton masën e gjobës. Pasi e bën këtë gjë, ia çon gjykatës për miratim. Gjykata ka të gjithë të drejtën ta

shqyrtojë këtë, në thelb, jo vetëm në procedurë. Pra, qëndron, është aplikuar drejt masa e dënimit është dhënë drejt etj. Në qoftë se gjykata e gjen me vend këtë vendos ta miratojë. Në momentin që e miraton, ia komunikon personit të akuzuar.

Këtu ka dy mundësi: nëse personi i akuzuar e pranon, jemi në rregull. Nëse personi i akuzuar nuk e pranon, thotë “nuk e dua zgjidhjen që më keni dhënë, do të shkoj në gjyq”. Kjo është e gjitha, nuk i preket asnjë gjë.

Çfarë propozon ministria?

Vexhi Mucmataj – Çfarë përfitimesh ka?

Henrik Ligori – Sigurisht, ka përfitime dhe logjika e kësaj është që ai nuk do ta kundërshtojë urdhrin për shkak se ka disa përfitime. Nuk i shënohet në dëshminë e penalitetit, i jepet gjysma e gjobës së parashikuar, nuk ka dënim me burgim, shpëton nga burgu, vendimi nuk vlen për efekte civile, është paguar dëmi, kështu që ai mendohet se do të jetë i kënaqur me këtë nëse mendon se e ka kryer veprën dhe përderisa e ka shqyrtuar në gjykatë, nuk ka shumë shanse të mos dënohet nëse shkon në gjyq.

Çfarë propozon ministria? Ministria thotë se këtij personi duhet t’i njoftohet urdhri penal dhe t’i merret pëlqimi. Nëse ndodh kjo, humbet komplet kuptimi i këtij instituti, madje shkon ndesh me etikën e procesit gjyqësor, sepse ne i kërkojmë të pranojë dënimin, por të mos pranojë fajësinë, që nuk ka sens t’i thuash: prano dënimin, por deklaroju i pafajshëm.

Nëse pranon fajësinë dhe dënimin, ne kemi procedurën e gjykimit me marrëveshje. Kjo e humbet komplet zhdërvjelltësinë e saj dhe nevojën që prokurori të vendosë të thjeshtojë punën e tij duke hequr çështjet e thjeshta.

Fatmir Xhafaj – I njofton prokurori dhe deri në marrjen e vendimit nga gjyqtari, pse të mos i ketë në dorë gjyqtari vendimin e prokurorit dhe reagimin e të pandehurit?

Henrik Ligori – Në qoftë se i pandehuri e pranon, është dakord...

Fatmir Xhafaj – Pse?

Atëherë, ti më ke sjellë mua urdhrin penal, ndërkohë më thua “ke 10 ditë kohë”. Brenda 10 ditëshit ai shprehet, i shkojnë gjykatës edhe kjo, edhe kjo.

Henrik Ligori – Humbet kuptimin.

Fatmir Xhafaj – E merr njoftimin.

Henrik Ligori – Humbet kuptimi i ritit, sepse kjo kërkon një procedurë. Gjukata vendos pa dijeninë e tij dhe ai e pranon nëse do dhe nëse nuk do, nuk e pranon.

Fatmir Xhafaj – Ai mund të ankohet më pas.

Henrik Ligori – Jo, nuk ankohet, ai e kundërshton dhe në këtë moment kjo procedurë është e mbyllur, çështja shkon në gjyq.

Artan Hoxha – Ajo që përfitohet është se nuk bëhen disa procedura që parashikon ligji, si: përfundimi i hetimeve, njoftimi i akuzës, që duan kohën dhe janë...

Fatmir Xhafaj – Ai duhet t'i njoftojë urdhrin penal të fundit, kur të ketë mbaruar këtë procedurë.

Artan Hoxha – Urdhri penal...

Fatmir Xhafaj – E çon në gjykatë dhe i thotë “Unë për ty, zotëri, kam nxjerrë këtë urdhër penal, do t'ia çoj gjyqtarit. Ke 10 ditë kohë të shprehesh”.

Artan Hoxha – Këtu është problemi, sepse ka një keqkuptim të madh. Kemi dy gjykime: një gjykim të zakonshëm, që shkojnë aktet pasi janë përfunduar të gjitha elementet që përfundojnë çështjen në hetimin paraprak dhe gjykimet e posaçme, që e ndryshojnë ritin e zakonshëm. Nëse ne do të pranohim këtë propozim, ne shkojmë me ritin e zakonshëm, por duke qëndruar me një këmbë këtej, një këmbë andej.

E para, i themi: “e pranon apo nuk e pranon?”. Nëse e pranon, do të thotë se kemi gjykimin me marrëveshje dhe, nëse e pranon, shkoj me marrëveshjen që më propozohet. Pra, nga njëra anë kemi urdhrin penal të prokurorit, i cili i propozon gjykatës zgjidhjen në mënyrë të njëanshme, dhe duam t'i shtojmë edhe konsensusin e të pandehurit. Po i shtove konsensusin, është gjykim i marrëveshje. Po i dhe të drejtën të ankohet, të njoftohet për të gjitha, është gjykim i zakonshëm.

Urdhri penal, ose qëndron kështu, ose nuk qëndron fare. Kjo është thelbësore. Çfarëdo gjëje që të bëjmë ne këtu, do të thotë që prishim konceptin e këtij gjykimi, vetëm se do ta quajmë “gjykim të zakonshëm” ose “gjykim me marrëveshje”, por nuk janë ato rregullat e tyre, vetëm se i ndryshojmë emrin dhe i themi “urdhër penal”. Urdhri penal, ose qëndron kështu dhe kështu është kudo, me ndonjë rregullim të vogël, por të njëanshëm, si caktimi i masave të sigurimit, që do të thotë se, ose është kështu dhe është gjykim i posaçëm, që hiqet fare dhe ka shumë përfitime. Mua do të më vinte shumë keq nëse do të hiqej si natyrë gjykim, sepse ka ekonomi gjyqësore, ka ekonomi për të gjithë pjesëmarrësit në proces, ka përfitim të jashtëzakonshëm për kundërvajtje penale, pothuajse e dekriminalizon kundërvajtjen penale.

Domethënë, sot në Shqipëri ne kemi kundërvajtje penale dënim me gjobë 3 vjet burg maksimumi, dhe janë shumë.

Çfarë ndodh? Ndodh që nëpërmjet urdhrit penal të prokurorit, për kundërvajtjet penale nuk do të aplikohet pothuajse dënimi me burgim.

Fatmir Xafaj – E qartë.

Si mendoni të dëgjojmë edhe miqtë tanë, partnerët që kanë punuar me Kodin, që ta ndajnë vendimin dhe ne të biem dakord. Domethënë, biem dakord ta pranojmë vendimin që do të thonë zonja Bumçi dhe zoti Smajber?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, t'i dëgjojmë!

Zoti Smibert, zonja Bumçi, kush do të flasë?

Këtu kemi nevojë për një arbitër dhe e mbyllim këtë pjesë.

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* Në diskutimin që bëmë dje pas mbledhjes me Ministrinë e Drejtësisë ne shprehëm mendimin se shtimi i detyrimit të prokurorit për ta njoftuar të pandehurin para se të dërgohet urdhri penal, është i mjaftueshëm, nuk ka nevojë për të shtuar elemente të tjera.

E shpjegova edhe dje në takim, që vendosja e urdhrit penal është e njëjtë si vendosja e një gjobe administrative.

Njoftimi i shton të pandehurit kohën që do të ketë ai për t'u përgatitur, deri në momentin që do të marrë urdhrin penal të miratuar nga gjykata dhe kontrollin e urdhrit penal do ta bëjë gjykata.

Me njoftimin e të pandehurit mendojmë se është adresuar shqetësimi i ministrit të Drejtësisë, por pse është i nevojshëm urdhri penal?

Së pari, është i nevojshëm, sepse do të mbushë buxhetin me vjeljen e shpejtë të gjobave.

Së dyti, do t'u japë kohë prokurorëve të përqendrohen në çështje më të rëndësishme, kohë që ata nuk e kanë nëse do të përqendrohen te kundërvajtjet penale.

Së fundi, në Kroaci fillimisht e lejuam urdhrin penal për vepra që dënoheshin deri në 2 vjet, kurse në vitin 2009 e ndryshuam ligjin dhe urdhrin penal e lejuam për vepra që dënoheshin deri në 5 vjet. Urdhrin penal ne e kemi parashikuar në legjislacion tonë që nga viti 1998 si një mjet shumë eficient në procedurën penale.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Unë do të përforcoj ato që tha zonja Bumçi, sepse urdhri penal është një mjet shumë i nevojshëm, është një mjet i domosdoshëm për të rritur eficiencën

e gjykatave, që është një nga qëllimet kryesore që ne patëm kur e filluam këtë reformë. Unë mendoj se janë ngritur tri shqetësime:

Së pari, është fakti që i pandehuri nuk merr njoftim për urdhrin penal, përveçse në momentin kur gjyqtari ka vendosur që urdhri penal do të miratohet dhe gjoba do të vendoset ndaj të pandehurit. Në mënyrë shumë të arsyeshme u pranua ky propozim dhe u shtua njoftimi i të pandehurit për urdhrin penal. Shtimi i elementeve të tjera, si shtimi i dhënies së pëlqimit nga i pandehuri, do të kuptonte që kjo ishte një procedurë tjetër dhe se vendimi i gjykatës do të ishte një vendim përfundimtar, por, në fakt, urdhri penal parashikonte që vendimi i gjykatës mund të kundërshtohet nga i pandehuri.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se këto procedura aplikohen për kundërvajtjet penale, pra për vepra jo të rënda, kështu që nuk do të kemi shumë të pandehur që do të marrin mundimin t'i kthejnë përgjigje prokurorit, sepse nuk është se do të përballen me një rrezik të madh, ashtu siç do të përballëshin në rastin e një krimi. Kështu që në qoftë se do të shtohet detyrimi i të pandehurit për të dhënë mendimin e tij, do të ndodheshim në një situatë, ku shumë të pandehur nuk do të kthenin fare përgjigje dhe gjykata do ta miratonte urdhrin penal duke e marrë të mirëqenë se i pandehuri e ka dhënë pëlqimin e tij, ndërkohë do t'i hiqnim atij mundësinë për ta kundërshtuar urdhrin penal. Pra, procedura nuk do të ishte më e drejtë se ajo që kemi, por do të ishte më pak e drejtë.

Kështu, unë mendoj se është e rëndësishme që urdhrin penal ta lemë kështu siç është, sepse e njofton të pandehurin për mundësinë e caktimit të një urdhri penal...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, vetëm njoftimin e të pandehurit, sepse ruhet efienca e gjykimit, ndërkohë ruhet edhe mundësia për të pandehurin që ta kundërshtojë urdhrin penal dhe të procedohet me gjykim të zakonshëm në momentin që ai e ka parë se çfarë ka urdhëruar gjykata.

Fatmir Xhafaj - Ky është një debat i pastër teknik.

Luan Rama – A mund të bëj një pyetje, zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj - Po.

Luan Rama – Çfarë pasoje negative ka për procesin nëse të pandehurit i jepet mundësia të shprehet në lidhje me urdhrin penal para se të shqyrtohet nga gjykata? Pra, prokurori vendos masën e urdhrin penal dhe ia njofton të pandehurit, por meqenëse procesi gjyqësor zhvillohet pa praninë e palëve pse të mos jetë edhe qëndrimi i të pandehurit pjesë e fashikullit, në mënyrë që

para gjykatës të jenë të barabartë edhe prokurori, që bën zgjedhjen për urdhrin penal, por edhe i pandehuri, që mund të shprehet se e pranon këtë zgjedhje të prokurorit? Pra, unë po flas pa shkuar çështja në gjykatë dhe jo të shprehet pasi është shprehur gjykata.

Nëse e kuptova drejt këtu u tha se i pandehuri vihet në dijeni pasi është shprehur gjykata. Atëherë, pse të vihet në dijeni i pandehuri për urdhrin penal dhe në gjykatë të shkojë bashkë me prokurorin si palë e barabartë?

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Bumçi.

Korajlka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Ne e kemi bërë këtë ndryshim të propozuar nga ministria, që i pandehuri do të njoftohet nga prokurori para se urdhri penal të çohet në gjykatë.

Luan Rama – Më falni, por këtu u tha që pasi shprehet gjykata për urdhrin penal kjo i njoftohet të pandehurit. Pra, jemi në...

Fatmir Xhafaj – I njoftohet urdhri të pandehurit, por nuk i merret pëlqimi më parë nëse është dakord apo jo. Pra, kjo është diferenca.

Luan Rama – Por çfarë vlere ka të njoftohet i pandehuri për urdhrin penal dhe nuk e lejon të shprehet, në mënyrë që t'i drejtohen gjykatës në mënyrë të barabartë edhe prokurori, edhe i pandehuri?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ligori.

Henrik Ligori – Nëse do të jepej kjo mundësi ka dy opsione:

Së pari, i pandehuri nuk e pranon dënimin me gjobë, sepse kërkon pafajësi. Këtu mbyllet çështja dhe nuk vazhdohet më me këtë procedurë.

Opsioni i dytë është që i pandehuri e pranon dënimin me gjobë dhe çështja shkon në gjykatë. Nëse i pandehuri e pranon edhe fajësinë, edhe masën e dënimi, atëherë nuk kemi urdhër penal, por jemi në një gjykim me marrëveshje, që është një lloj tjetër gjykimi. Nëse i pandehuri e pranon masën e gjobës, sepse i pëlqen dënimi i pakët, por nuk e pranon fajësinë, atëherë në këtë kuptim bie ndesh me të gjithë etikën gjyqësore, sepse si mundet që një i pandehur të pranojë një dënim dhe të mos pranojë fajësinë. Kjo nuk shkon, ndërkohë që procedura është shumë e thjeshtë, bëhet midis prokurorit dhe gjykatës, njoftohet ai paraprakisht. Vendimi i gjykatës nuk e cenon këtë person. Këtij po i erdhi, mirë e pranon, nëse nuk do, thotë jo: nuk më pëlqen dhe do të shkoj në gjyq, por favoret që ka, i kanë bërë ata që e kanë shpikur këtë mjet procedural, të mendojmë se në shumicën e rasteve do ta pranojë, sepse dënimi është i pakët, pa këto nuk i regjistrohesh në

gjendjen gjyqësore, nuk i vlen për efektet civile e të tjera, ndërkohë që atij nuk i preket asgjë, sepse ai nëse nuk i pëlqen, mund të shkojë në gjyq...

Fatmir Xhafaj – Praktikisht kalojmë në një proces tjetër nëse ndodh kjo, te gjykimi me marrëveshje.

Luan Rama – A nuk bie ndesh kjo me parimin e barazisë së palëve në një proces gjyqësor? Ti i jep prioritet prokurorit, sepse thoni: marrëveshje prokuror -gjykatë dhe përjashton të pandehurin në këtë rast.

Henrik Ligori - Nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë. Pse? Në fillim duket sikur prokurori ka një avantazh, gjen një zgjidhje që i duket e përshtatshme dhe ia propozon gjykatës.

E para, kemi kontrollin e gjykatës mbi zgjedhjen e prokurorit.

E dyta, në momentin që ky vendim i gjykatës i njoftohet personit të akuzuar, ekuilibri rivendoset. Këtu barazia është absolute, sepse ai nëse nuk i pëlqen, nuk e pranon, ai shkon në gjyq.

Luan Rama - Në vlerësimin tim, është barazi *post factum*, sepse ti nuk më jep të drejtën të shkoj i barabartë me prokurorin në gjykatë.

Fatmir Xhafaj - Është në favorin tënd.

Luan Rama - Një minutë!

Dakord. Më lejo që edhe unë të shprehem te gjykata, se e pranoj këtë gjë që është në favorin tim, ose që nuk e pranoj këtë gjë që është ë favorin tim, sepse nuk arrij ta kuptoj. Po flas për të sqaruar deri në fund që të mos krijojmë asnjë ekuivok për të komentuar. Meraku im është barazia e palëve në proces gjyqësor, pavarësisht se këtu kemi të bëjmë me një proces gjyqësor që lidhet me urdhrin penal përsëri para gjykatës, kam parasysh të gjithë mënyrën sesi është konceptuar gjykata me ndryshimet që janë bërë. Unë gjykoj se çfarë të keqe ka nëse ndodh që i jepet e drejta të shprehet? Pastaj është çështje tjetër se çfarë vendos gjykata.

Dashamir Peza – Problemi është se ne duhet të kuptojmë një gjë shumë të qartë, mendoj unë.

Fatmir Xhafaj - Ju lutem!

Ajo është një gjë kaq ndihmuese për njerëzit, keni parasysh të gjithë ata që janë dënuar deri tani me burg 2 vjet për kundërvajtjeje, a e kupton se çfarë është kjo? Është një avantazh shumë i mirë për ta depenalizuar të gjithë këtë. Kjo ka qenë një nga kërkesat e qeverisë dhe të ministrisë.

Dashamir Peza - Problemi qëndron se ne po fusim një formë të re gjykimi. Këtë formë të re gjykimi...

Fatmir Xhafaj - Është një institut krejt i ri.

Dashamir Peza - ...ta transformojmë dhe ta kthejmë si një formë të vjetër gjykimi. Kjo nuk cenon ndonjë të drejtë të të pandehurit, për arsye se i pandehuri ato të drejta që ka sot i mbeten edhe në vazhdimësi: ai ka të drejtë ta refuzojë këtë gjykim, ka të drejtë të ndjekë procedurën tradicionale të gjyqimit në vijimësi, por ne nuk mund të prodhojmë një formë të re të të gjykuarit dhe ta kthejmë këtë, ta bëjmë të ngjashme me atë që ishte. Zgjedhja jonë është: ose e pranojmë, ose e refuzojmë. Kështu mendoj unë. Nuk e kuptoj se çfarë i cenohet qytetarit nga ajo që kemi sot, në të drejtën e tij. I mbetet e drejta që ka sot për të refuzuar këtë gjykim dhe për të shkuar në procedurën tradicionale. Nuk ka asnjë lloj pasoje nga ky lloj vendimi, nuk i cenohet asnjë e drejtë nga ato të drejta të cilat i ka sot. Ne duhet të zgjedhim: duam ta prezantojmë këtë formë të re...

Fatmir Xhafaj - Ky është një debat teknik, sepse edhe ministria e kërkon këtë, sepse shkon ndesh me atë që ka bërë gjithë këto kohë.

Dashamir Peza - Zoti kryetar, mua më shqetëson një gjë, se sa herë që fusim diçka të re, duam ta bëjmë si gjë të vjetër. Në kuptimin e asaj që t'i ngjajë gjësë së vjetër. Unë mendoj se nëse fusim një gjë të re, duhet ta pranojmë atë që të ruajë fizionominë dhe qëllimin që ka. Nëse nuk duam ta prezantojmë këtë gjë të re, kemi të drejtën të ngremë dorën dhe të themi: “Nuk e duam, le të hiqet kjo si formë”, por ne nuk mund ta bëjmë me hemafrodite këtë lloj zgjedhje.

Faleminderit!

Luan Rama- Me leje, zoti kryetar?

Jam krejt dakord me atë që thotë zoti Peza, në kuptimin që jam pro krijimit të këtij instituti të ri, e çmoj si një novitet dhe kontribut për t'ia lehtësuar peshën apo përgjegjësinë të pandehurit në proceset që përgjithësisht janë konsideruar të rënda dhe që kanë rënduar të gjithë sistemin e dënimit penal, burgjet e të tjera. Nëse bëjmë debat për ta qartësuar deri në fund mjegullnajën apo paqartësinë që ka secili prej nesh, kjo nuk do të thotë se jemi kundër.

E dyta, ne jemi në komision që të qartësojmë edhe presjen e fundit edhe për të respektuar të gjithë atë punë të mirë, kolosale që është bërë edhe për ta mbyllur procesion e miratimit me çdo gjë të qartësuar maksimalisht, prandaj nëse unë pyes, kjo do të thotë se jam i interesuar të dijë deri në fund, se cili është raporti i palëve në proces, sepse pavarësisht faktit se kemi të bëjmë

me një urdhër penal, është në fund të fundit një proces gjyqësor, edhe shqyrtimi i urdhrit penal, pasi e ka vendosur atë prokurori. Nga kjo pikëpamje nuk kemi asgjë kundër, por thjesht dua të qartësohet çdo gjë, të qartësohen edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë në raport me pretendimin apo me ato objeksione që ata kanë. Ky është merakun im dhe nuk kam asnjë arsye tjetër.

Faleminderit!

Artan Hoxha - Veç kompromisit të parë, që kërkesa për miratimin e urdhrit penal i njoftohet të pandehurit paraprakisht, përpara se ajo të merret nga gjykata, me qëllim që t'i jepet atij kohë të reflektojë lidhur me këtë urdhër, ne duhet të jemi të sigurtë që ky urdhër i dhënë në mënyrë të njëanshme, i miratuar në mënyrë të njëanshme nga gjykata, duhet të mos jetë një urdhër që mund të vihet në vlerësim nëse pranohet kundërshtia e të pandehurit apo jo. Pra, në pikën 2, të nenit 406, germa "ç", kur kemi thënë se kundërshtimi nuk pranohet kur ai është bërë nga një person i palegjitimuar ose kur paraqitet jashtë afatit, do të thoshim se kundërshtimi nuk mund të refuzohet nga gjykata dhe është detyruese për gjykatën jo në vlerësimin e saj, me përjashtim të rasteve kur janë dy të tjera, sepse kur vijmë te pika 3, thuhet se kur e pranon kundërshtimin gjykata, çështja kalon për gjykim. Pra, duket sikur është...

Fatmir Xhafaj – Të lëmë fjalët "të menjëhershme", por kundërshtoi ai automatikisht.

Artan Hoxha– Po e bëri, është automatikisht e pranueshme. Ai dyshim që kemi pasur në diskutime me termat "mund" them se e plotëson atë që e gjithë kjo veprimtari është një veprimtari, e cila nuk sjell pasojë nëse pranohet nga i pandehuri, është një avantazh shumë i madh që nuk duhet të humbet, por po i lëvizte një element, jo dy sa kërkojmë ne, rrëzohet, nuk është më urdhër penal. Do ta gënjejmë veten, do t'i vëmë një emër urdhrit penal, por nuk është në asnjë vend kështu.

Fatmir Xhafaj - Ka dy ndërhyrje.

Artan Hoxha - Me këto dy ndërhyrje...

Fatmir Xhafaj - Besoj se jeni dakord. Profesorin nuk e kisha parë ndonjëherë kaq tolerant. Dje na mbajti 4 orë për një nen, dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam qenë me dhimbje koke dje.

Bledar Dervishaj – Edhe unë po ashtu.

Fatmir Xhafaj – Bashkë ishim, bashkë.

Bledar Dervishaj – Në fund të fundit, të gjitha këto konsensusse janë përmbushje e standardeve që na vendos Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Nuk po dalim për *change* fytyre të tyre. Ne atë po kërkojmë: të drejtën që të dëgjohemi.

Fatmir Xhafaj – Këtë ia dha edhe si mundësi, që kundërshtimi i menjëhershëm dhe gjykata e ...

Bledar Dervishaj – Sepse edhe dje kemi diskutuar midis variantit european dhe atij amerikan. Varianti amerikan nuk e ka urdhrin penal, ndërsa në Europë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ne po marrim më të mirën tashti, ç'ëndësi ka. Po ta kishte Amerika gjë të mirë...

(Ilaritet në sallë)

Bledar Dervishaj – Ne nuk jemi kundër urdhrin penal, sepse u hodh ideja që të hiqet fare.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo. As që e diskutoj fare.

Bledar Dervishaj – Nuk jemi për heqje.

Ky mekanizëm u ofron të pandehurve shumë lehtësi, por hajt t'u rrisim ankthin se çfarë do të ndodhë me akuzën ndaj tij, duke e nxitur paksa edhe në pranimin e fajësisë, se ndonjëherë nuk kundërshtohet, me idenë: hajt, se jam me gjobë. Këtë do të donim të shmangnim. Domethënë, të njoftohet, është propozim i kërkuar e mirëpritur edhe nga ne, që të njoftohet...

Fatmir Xhafaj – Po, dhe kanë rënë dakord me propozimin tuaj. Ranë dakord edhe që të...

Bledar Dervishaj – Mund të heqim fjalën “pëlqim”, se duket e madhe, por të shprehet te prokurori, te procesverbali, kur merret në pyetje.

Fatmir Xhafaj – Po atëherë kalon te marrëveshja, te parashikimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Dervishaj – Sepse dakordësia... në nuk po themi që t'i japë dakordësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Në rregull, në rregull! Ju lutem, ju kishit një pikëpamje, këta kishin një pikëpamje, arritëm të gjejmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me ndryshimet që u propozuan? Me ndërhyrjen e ministrisë, që miratuam të parën, dhe me ndërhyrjen e dytë të profesorit, bëhen dy ndërhyrje. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Unë kam një pyetje, dhe këtu e mbyll, sepse mendimin tim për këtë dispozitë e kam shprehur. Pyetja ime është krejt e thjeshtë: Do ta njoftojë prokurori me urdhrin penal, do ta vërë në dijeni prokurori – quani si të doni, ose njoftim, ose vënie në dijeni. Në qoftë se unë e pranoj, çfarë do të kundërshtoj në gjykatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, të qartësohemi...

Artan Hoxha – A ta them unë, që të mos ngatërrohet gjëja tani?

Ulsi Manja – Profesor, unë e kam pyetjen të thjeshtë: pranuat edhe elementin e njoftimit nga prokurori, të drejtën që gjykata ta pranojë automatikisht kundërshtimin, apo pranuat vetëm variantin taksativ, që gjykata...

Fatmir Xhafaj – Të lutem, me gjithë respektin që kam për kolegët, gjë që ti e di, ne e kaluam atë tashti. Mos t’i hyjmë sërish.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti je i sqaruar tashti, por do t’i shkosh deri në fund asaj egos tënde profesionale.

Ulsi Manja – Jo egos. Unë i kam shprehur qëndrimet e mia, e do t’i shpreh edhe me votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam pro këtij instituti, në variantin e paraqitur nga ekspertët, pa asnjë lloj modifikimi.

Fatmir Xhafaj – Po tashti, ekspertë janë ata...

Ulsi Manja – Të lutem, ky është mendimi im personal. Unë i nënshtrohem vullnetit të komisionit, po për këtë nen kam këtë qëndrim.

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, dakord, këtë e mbyllëm, po them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E votuam këtë. tani të vazhdojmë me ndryshimin e nenit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Më fal, shumë i nderuar profesor, të gjithë kemi pasur fat të japim mësim, kush nuk e ka pasur këtë fat të ndjehet keq. Kleanthi Koçi e thoshte këtë. Dy juristë, tre mendje. A e kuptoni nëse janë shtatëmbëdhjetë, sa mendje janë? Prandaj, ju lutem, sepse s’e kam të lehtë t’i menaxhoj të gjithë.

Vazhdojmë me ndryshimin e nenit 432: “Shkaqet për rekurs”.

Vasilika Hysi – Duke pasur parasysh që kjo dispozitë u la hapur, dje, pas mbledhjes, pati një diskutim të gjerë me ekspertët, gjithashtu edhe me misionin Euralius, e u ra dakord që shkaqet e rekursit ose dispozita, që në Kodin e Procedurës Penale njihet me emërtimin rekursi në Gjykatën e Lartë, duhet të unifikohet me përmbajtjen e re që ka Kushtetuta, neni 141 për rolin e Gjykatës së Lartë, me parashikimin e shkaqeve të rekursit në ligjin “Për gjykatat administrative” dhe në Kodin e Procedurës Civile.

Pas diskutimeve dhe debateve, mendojmë se riformulimi që ju, të nderuar kolegë, keni mbi tavolinë, i përgatitur nga grupi i ekspertëve, është i pranuar.

Nuk e di nëse zoti Hoxha...

Fatmir Xhafaj – Ishte dje edhe zoti Hoxha, edhe zoti Dervishi, edhe ne të gjithë.

Vasilika Hysi – Lidhur me riformulimin e nenit 432 si më poshtë, siç e keni në draft. Pra, vendimet e shpallura nga Gjykata e Apelit në rastet që parashikohen në këtë ligj, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë:

a-Për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

b-Kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Penal ose kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë.

c-Ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit.

Fatmir Xhafaj – Ka gjë në lidhje me këtë?

Po.

Henrik Ligori – Këtu kemi disa gjëra, të cilat lidhen me veçoritë e procesit penal, në dallim nga procesi civil e administrativ.

Le t’i marrim me radhë:

Te pika “a” nuk kemi ndonjë gjë thelbësore, por na duket sikur nuk shkon që, zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural, të lidhet me zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në qoftë se një gjë është e gabuar, nuk mund të zhvillojë asgjë. Kështu, mbase fjala “zhvillimi” duhet parë nëse duhet të qëndrojë apo jo.

Tek pika 2 jemi plotësisht dakord, por është çështje formulimi. Vendimi i ankimuar i ndryshëm nga praktika e kolegjit. Një vendim nuk mund të jetë i ndryshëm nga një praktikë kolegj. Vendimi është një akt, ndërsa praktika e kolegjit zgjidh çështje të ligjit. Ndaj themi se mund të jetë

një formulim më i mirë ky që po citoj: “kur zgjidhja e dhënë me vendimin e ankimuar ndryshon thelbësisht nga praktika thelbësore”. Pra, këtu duhet futur edhe një element i ndryshimit thelbësor, sepse jo çdo ndryshim, sado i vogël nga praktika gjyqësore, duhet të penalizohet me rekurs.

Fatmir Xhafaj – Ju e keni pranuar se mund ta marrë çështjen edhe thjesht për njësim praktike, pa pasur as ndryshim, dhe nuk e pranueni e dashkeni ndryshim thelbësor. Po ju e keni pranuar. Ky ka qenë vullneti i kushtetutëbërësit.

Henrik Ligori – Megjithatë, për ne është më me rëndësi pika “c”.

Fatmir Xhafaj – Po?

Henrik Ligori – Sepse këtu është futur termi “shkelje me pasojë pavlefshmërinë e procedurës së gjykimit”. Në penale nuk ka koncept të pavlefshmërisë së procedurës, as në tekstin e kodit e as në doktrinë. Elementi i parë.

E dyta, ka dy shkelje, në të cilat, sipas nenit 128, gjykata është e detyruar t’i konstatojë edhe kryesisht; s’ka nevojë ta vënë palët në lëvizje. Është e detyruar t’i ngrejë pavlefshmërinë e akteve e papapërdorshmërinë e provave, që janë tipike për procedurën penale, sidomos papërdorshmëria e provave.

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, mund të themi: “Ka shkelje të rënda të normave procedurale”.

Henrik Ligori – Nuk ka nevojë të thuhet “shkelje të rënda”, sepse nënkuptohet se shkelja është e rëndë përderisa ngrihet, por themi: “Për shkelje të normave procedurale”.

Fatmir Xhafaj – Për çdo lloj shkelje?

Henrik Ligori – Për çdo lloj shkeljeje me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve dhe papërdorshmërinë e provave.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Henrik Ligori – Kjo e plotëson dhe e bën më afër konceptit që ka procedura penale.

Fatmir Xhafaj – Dakord me “c”-në? A ka ministria ndonjë propozim për ndryshim? Dakord? dakord për “c”-në. A janë dakord edhe ekspertët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, e sotmja. E lexoi ai.

Dakord me ndryshimin e 432-shit.

Këtë shtesën që pas nenit 435 shtohet neni...?

Vasilika Hysi – Lidhur me shtesën që diskutuam dje për të thënë: “Gjykata vendos në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga

sa parashikon neni 432”, ne e gjejmë të pavend pasi në Kodin e Procedurës Penale thuhet konkretisht rastet kur nuk pranohet rekursi. Pra, ka një rregullim te neni 433 “Mospranimi i rekursit”.

Fatmir Xhafaj – Me një fjalë, është dhe nuk kemi nevojë për ndryshim.

Vasilika Hysi – E vetmja gjë që mund të shtohet, nëse bien dakord ekspertët, është të citohet neni...

Fatmir Xhafaj – Mospranimi i rekursit në dhomë këshillimi?

Vasilika Hysi – ...për shkaqet që parashikohen.

Fatmir Xhafaj – Është diskutimi që bëmë dje.

Vasilika Hysi – Po.

Pra, neni 433 flet për mospranimin e rekursit.

Fatmir Xhafaj – Ka nevojë për ta shtuar, për ta forcuar apo është mirë siç e keni te neni 433?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ligori? Ministria?

Ka nevojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Neni 441 “Vendimet e Gjykatës së Lartë”.

Vasilika Hysi – Ekzakt.

Tani, te neni 441 ligji aktual, Kodi i Procedurës Penale, përmend termin “dispozitiv i vendimit”. Ne ramë dakord dje për të unifikuar terminologjinë.

Fatmir Xhafaj – “Vendimet e Gjykatës së Lartë”, - thamë.

Vasilika Hysi – Po, të ndryshohet titulli, por njëkohësisht të bëhet edhe një riformulim nga ai që është në draft.

Fatmir Xhafaj – Dakord, siç është këtu.

Vasilika Hysi – Me të vetmin ndryshim, zoti kryetar, që në germën “a” të bëhet, e para, lënia në fuqi e vendimit.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord, siç është këtu, germet “a”, “b”, “ç” dhe “d”. Bledar, besoj se jemi dakord, se e diskutuam edhe dje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lidhur me njoftimin, kemi rënë dakord.

Vasilika Hysi – Lidhur me njoftimin...

Fatmir Xhafaj – Me shpallje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Me shpallje besoj.

Tani, unë kam edhe një shqetësim tjetër, që u ngrit edhe dje, dhe ndoshta doli nga vëmendja: rishikimi.

Përpara se të shkoj tek...

Rishikimi është te neni 449 ose...

Fatmir Xhafaj – Që ta mbyllim përfundimisht.

Vasilika Hysi – ...neni 255 i projektligjit.

Në nenin 255, zoti kryetar, grupi i ekspertëve ka bërë një riformulim të rishikimit të vendimeve.

Fatmir Xhafaj – Dyqind e...?

Vasilika Hysi – Neni 255, që ndryshon nenin 449.

Fatmir Xhafaj – Po?

Vasilika Hysi – Vendimet që mund të rishikohen.

Në ligjin aktual thuhet: “Në rastet e caktuara me ligj lejohet që në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formën e prerë edhe kur dënimi është ekzekutuar ose është shuar” (paragrafi i parë), kurse në paragrafin e dytë thuhet: “Vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikohen me kërkesën e prokurorit, por me kusht që të mos kenë kaluar pesë vjet nga dhënia e vendimit”.

Kolegët kanë sjellë një formulim të ri, i cili ndryshon totalisht nga formulimi...

Fatmir Xhafaj – Kush e ka sjellë?

Vasilika Hysi – Ekspertët, grupi i punës.

Fatmir Xhafaj – Le ta lexojnë ata, ta thonë.

Artan Hoxha – Rishikimin për pafajësinë e kemi hequr. Është një standard i ri, që kemi futur në proces: “Rishikimi i një vendimi pafajësie i formës së prerë, sipas Kodit të pandryshuar, lejohet të bëhet brenda pesë vjetëve që është dhënë vendimi”.

Nëse gjykata të ka deklaruar të pafajshëm, vendimi ka marrë formën e prerë, i ka kaluar të gjitha instancat dhe nesër lindin shkaqet e rishikimit, që janë provat e reja e me radhë, brenda një

afati pesëvjeçar sot mund të rishikohet, ne themi: pafajësia është pafajësi, është siguri juridike dhe nuk duhet të rishikohet nëse i ka kaluar të gjitha fazat e procedimit penal. Ne themi se kjo është një zgjidhje, që shkon me standardet europiane sot. Për shembull, në shtete të tjera, ku kanë juri që në shkallën e parë, po të jetë se japin pafajësinë, ti nuk vazhdon dot më as më tutje. Domethënë, procesi penal nuk ka nevojë të rëndohet edhe më tej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zoti Rakipi mendon ndryshe?

Arben Rakipi – Po, po, ndryshe, nuk ka standard të tillë, përkundrazi, standardi është për të riparë çështje të mbyllura nëpërmjet rishikimit gjithmonë kur gjenden prova të reja.

Aq sa unë kam kontribuar në këtë çështje jam i detyruar ta them këtë, sepse jam krejtësisht kundër me... Domethënë, standardi i mungesës së rishikimit mund të diskutohet atëherë kur është juria prezente, por jo gjyqtarët profesionistë. Kështu që unë them se dispozita duhet modifikuar, madje edhe dispozita aktuale, që e kushtëzon rishikimin deri në pesë vjet, nuk ka logjikën e të bërit drejtësi.

Fatmir Xhafaj – A ta lëmë ta bëjmë një debat po ta votojmë këtë në parim dhe meqenëse ky nen është ta lëmë të hapur këtë që ta diskutojmë me ekspertët...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A keni një mundësi ju që ta diskutoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, një minutë!

Artan Hoxha – Tani, ky është një propozim që ne nuk e kemi bërë se dolëm nga hiçi, kemi diskutuar gjatë, është gjithë kjo punë, është e studiuar, e menduar, e debatuar dhe kemi arritur në këtë përfundim, e kemi kaluar te ju dhe nuk ka qenë asnjëherë çështje një debati, e kaluat edhe ju me votë...

Fatmir Xhafaj – Po.

Artan Hoxha – Unë them se ka një mentalitet edhe procesi penal, se nuk mund të shkojë procesi penal pafundësisht. Është detyra jote si shtet t'i provosh tjetrit fajësinë. Nuk ke arritur t'ia provosh, ke përfunduar, je verifikuar nga të gjitha shkallët e gjykimit, është një e drejtë, mbaroi ajo. Tani, riktheju me shkaqe rishikimi dhe futu nëpër procedura të tjera pasi ka përfunduar, ke dhjetë vjet që bën gjyqe, çfarë interesi ka? As shoqëria nuk ka më interes. Pra, duhet një mentalitet, se nuk rëndohet shoqëria, por lehtësohet. Kjo është çështje mentaliteti, se nga çfarë këndvështrimi

e sheh. Po e pe me këndvështrimin që çdo gjë do ta penalizosh, do ta ngarkosh, do ta sjellësh, atëherë është ky këndvështrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që ne e kemi debatuar, pra nuk kemi çfarë të debatojmë më në grupin e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Cili është mendimi i ekspertëve të EURALIUS-it meqenëse ne do të hyjmë në BE? Si na pranoni ju në BE, me apo pa këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se pastaj thoni: “Nuk e ka Shqipëria mirë standardin e të tjera”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Hoxha, mos i bëj presion BE-së.

(Ilaritet në sallë.)

E sqaron Bruna.

Kur ka nevojë për qartësi Amerika, BE-ja, e sqaron Amerika, mos kini merak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korajlka Bumci – *(përkthen përkthyesja)* E kujtoj tani diskutimin. Mendoj se propozimi i bërë është i saktë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – ...zoti kryetar, është shtuar edhe një element tjetër nga dispozita aktuale. Pra: “Nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë, por as rishikimi i vendimit të dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit”. Kjo është një shtesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Edhe diçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E fundit, dje kemi lënë të hapur nenin 245, kam shënimin këtu, për përbërjen e kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe Kolegjit Penal, dhe thuhet se në nenin 433 do të bëhen ndryshimet e mëposhtme, ku ju thoni se do të ketë gjykim në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë, ndërsa seancat e kolegjeve do të jenë me pesë gjyqtarë. Ky është diskutimi që thamë, zoti kryetar, në raport me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Përfundimisht duhet ta lëmë edhe për rekorde, sepse nëse do të pranohet kështu siç kërkon grupi i punës duhet të bëjmë amendimin.

Fatmir Xhafaj – Po, te Kodi i Procedurës Civile.

Vasilika Hysi – Aty është me tre.

Fatmir Xhafaj – E kemi lënë me tre?

Vasilika Hysi – Po, me tre.

Fatmir Xhafaj – Edhe këtu me tre, atëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Këtu është me tre, ndërsa grupi i ekspertëve e ka sjellë me pesë, ndërkohë që te ligji që kemi miratuar “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” është me tre.

Artan Hoxha – Tani, ju e kaluat dispozitën transitore, e cila në fund mbyllet: “Përbërja e trupave gjykues rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligjet e tjera”. Ky është diskutimi që kemi bërë për formimin e trupave gjykues për procesin penal, se në procesin penal po rregullojmë. Prandaj nuk i prekim ligjet drejtpërdrejt, se në të kundërt, mund të krijojmë një konfigurim të ndryshëm.

Cili është ndryshimi? Ndryshimi është që në procesin penal Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duhet të gjykojë me 5 gjyqtarë në seancë publike dhe nuk mund të gjykojë me 3 anëtarë dhe ta unifikojë praktikën gjyqësore, ashtu siç thotë ligji i posaçëm. Ne kemi thënë (është një dispozitë shumë elegante, e cila nuk e dëmton as rregullimin tjetër), që për çështje të gjykimit penal zbatohen rregullat e këtij ligji, pavarësisht rregullimit të ndryshëm që është diku tjetër.

Them se kjo është shumë harmonike.

Vasilika Hysi – Zoti Hoxha,

Unë nuk jam absolutisht kundër idesë suaj. Unë jam që ju duhet të kemi një përbërje sa më të plotë, sa më cilësore, madje të zgjidhen edhe gjyqtarët më të mirë të Gjykatës së Lartë.

Unë ngre tani një çështje përplasjeje të të dyja ligjeve dhe këtu, në komision duhet të vendosim nëse do të miratohet kjo, do të shfuqizohet diçka tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Hoxha – Nuk ka përplasje, zonja Hysi. Po të lexohet dispozita, nuk ka përplasje. Aty thuhet: “Përbërja e trupave gjykuese rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligjet e tjera”. Domethënë, nuk të krijon situatën, sepse në ligjet e tjera, zonja Hysi, është marrë përsipër që (në ligjin për organizimin gjyqësor të përcaktohen në

mënyrë të përgjithshme përbërjet e trupave gjyquese në të gjitha shkallët e gjykimit). Ato mund të jenë të ndryshme nga gjykimi penal në gjykimin administrativ, jo vetëm për Gjykatën e Lartë. Me këtë ne nuk e prekim tërësinë e ligjit tjetër, por themi që përbërja e trupit gjyqës sipas procesit penal, është ky që ka Kodi i Procedurës Penale dhe nuk e prekim për procesin civil apo atë administrativ, të cilët kur t'u vijë koha mund të ndërhyhet në ligjet respektive, ose do të bëhet i njëjti formulim. Me këtë rast ju nuk keni nevojë t'i kaloni këto ligje në parlament për t'i ndryshuar, sepse këto janë edhe ligje të reja.

Vasilika Hysi – Në radhë të parë të tria ligjet për të cilat ju po flisni, zoti Hoxha, janë në proces diskutimi në komision, madje janë kaluar dhe unë do të doja të theksoja edhe një herë, që ne nuk kemi një ligj të veçantë për Gjykatën e Lartë, por kemi ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Në nenin 31 thuhet: “Kolegjet dhe trupat gjyquese në Gjykatën e Lartë” dhe në paragrafin e tretë të këtij ligji thuhet: “Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe për çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Ai gjykon me trupa gjyqës të përbërë nga 3 gjyqtarë (pra, po flet për Kolegjin Penal), çështje penale të gjykuara nga gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykon me një trup gjyqës të përbërë nga 5 gjyqtarë.” Pra, nuk është lënë që përbërja e trupit gjyqës të gjykohet me një ligj të posaçëm, siç është Kodi i Procedurës Penale.

Artan Hoxha – Pse, ai ligj do ta autorizojë Kodin e Procedurës Penale?

Vasilika Hysi – Edhe ky është me 3/5 dhe është ligj për organizimin.

Artan Hoxha – Le të jetë me 10/15. Ky është Kodi i Procedurës Penale.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Hoxha!

Kodi i Procedurës Penale nuk është as prona juaj, as prona ime. I njëjti parlament i ka miratuar të dyja ligjet. Këtu nuk ka 2 parlamente, por ka vetëm një.

Zonja Hysi ka një të drejtë, kur thotë që ne e kemi vendosur te ligji kuadër këtë që e rregullon këtë gjë dhe nuk mund ta rregullojmë sa herë që ju bëni doktrina në fusha të caktuara dhe ta përshtatim sipas doktrinave specifike. Këtu ka një qëndrim të unifikuar për këtë. Te rasti kur gjykohen dhe merren vendime te Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata Antikorrupsion, gjykohet me 5. Te këto do të gjykohet me 3 dhe me dhomë këshillimi.

Kur bëhet praktika që ka nevojë për kolegjet e bashkuara, do të gjykohet në kolegjet e bashkuara. Nuk kemi pse të merremi me këtë.

Vasilika Hysi – Mund të shtoj edhe diçka për ta mbyllur këtë diskutim? Nëse ne do ta miratojmë nenin 145, që ndryshon nenin 433 të

Fatmir Xhafaj – Nuk do të bëjmë ligjin. Po të dojë ta ndryshojë nesër, le ta ndryshojë. Këtu do të jemi. Ky Kuvend e ka ndryshuar një herë atë ligj dhe nuk mund të kalojë. Tani vjen dikush tjetër dhe thotë që do ta kalojë. E kemi kaluar një herë. Tani është shprehur vullneti i ligjvënësit disa muaj më përpara. Tani do ta ndryshojmë sot?

Vasilika Hysi – Të lutem, sa ta mbyll!

Fatmir Xhafaj – Po çfarë do të mbyllësh?

Vasilika Hysi – Vullneti i ligjvënësit ka qenë, që për krimet e rënda...

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U mbyll.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sipas atij ligji do të lihet, se ai është ligji kuadër për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë.

Urdhëroni, zoti Rama!

Luan Rama – Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk ndërhyra gjatë diskutimit të neneve, nëse çështja lidhet me një mori nenesh, por edhe ju thatë dhe në mbledhje që të shikohet mundësia e riformulimit të emërtesës “dëshmitar anonim”, për shkak të një konotacioni negativ që ka termi “dëshmitar anonim”, u tha dje që të shikohet mundësia e riformulimit të këtij termi, si për shembull: dëshmitar me identitet të mbrojtur ose të fshehur.

Fatmir Xhafaj – Po, e kanë zgjidhur.

Luan Rama – E dyta, që kisha është në lidhje me termin “viktimë”.

Fatmir Xhafaj – Ata kanë bërë gjithë atë debat në lidhje me këtë. Po na e hape prapë këtë...

Luan Rama – Jam i detyruar ta hap këtë debat, sepse ky ligj miratohet për të vepruar në Republikën e Shqipërisë dhe do të ketë të bëjë me qytetarët shqiptarë. Termi “viktimë”, i përdorur në mënyrë unike për çdo rast, edhe kur është fjala për një të dëmtuar apo të dëmtuar akuzues,

krijon një konotacion negativ, sepse në shqip “viktimë” do të thotë një njeri i vdekur, i vrarë nga aksidenti. Kam marrë këtu edhe fomulimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe për fjalën “viktimë” , që thotë shprehimisht: “Viktimë është ai që plagoset a vritet në një aksident, që dëmtohet apo vdes nga tërmeti, përmbytjet ose që vritet apo plagoset nga dikush, etj.”

T’i drejtohesh një të dëmtuari në seancë gjyqësore me termin viktimë, është jashtë psikikës dhe jashtë perceptimit normal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte e para.

E dyta, edhe Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe është një ligj. Aty ku është e mundur, nuk ka...

Fatmir Xhafaj – A kemi mundësi që të mos ta zbatojmë? Si janë konventat?

Luan Rama – Jam dakord që në konventa, në anglisht, fjala “viktimë” ka tjetër kuptim dhe në shqip ka tjetër kuptim. Kjo fjalë e ka fituar qytetarinë në rastin e viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, por në një proces gjyqësor, t’i drejtohesh qytetarit në sallë: “Çohu ti viktimë, në rastin e të dëmtuarit apo të dëmtuarit akuzues”, është jashtë perceptimit logjik të termit.

Ka edhe një tjetër kuptim pexhorativ fjala “viktimë”. Themi viktimë për dikë që është i mbaruar dhe nuk ka asnjë lloj vlere. Prandaj, natyrisht, kodi vendos një standard, por ai nuk mund të mos konsiderojë edhe disa realitete, që lidhen me normën që është e detyruar të zbatohet, kriteret e gjuhës letrare shqipe.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vexhi Muçmataj – Lidhur me përkufizimin e termit “viktimë e veprës penale...”

Fatmir Xhafaj – Atë të dëshmitarit e hoqe një herë. Dakord, e mbyllëm atë.

Po këtë përse e ke?

Vexhi Muçmataj – Për këtë që po diskuton zoti Rama.

Fatmir Xhafaj – Ndjesë, se nuk ju kuptova!

Ulsi Manja - Lidhur me përkufizimin e termit “viktimë e veprës penale” është e vërtetë që kodi ka bërë një risi të madhe me heqjen dorë nga termi: “i dëmtuar” dhe “i dëmtuar akuzues” dhe ka futur konceptin e viktimës dhe të viktimës akuzuese, dhe në debatet e grupit të punës ka qenë shqetësim përcaktimi i termit “viktimë”.

Natyrisht, i jemi shmangur këtij debati me idenë se Kodi ynë i Procedurës Penale nuk ndjek linjën e përkufizimeve. Pra, siç ka kode ku në nenet pas parimeve, ka edhe përkufizime.

Në Kodin e Procedurës Penale ne kemi ndjekur këtë linjë, që të mos ketë përkufizime, por OPDAT-i ka pasur një përkufizim lidhur me termin “viktimë”, të cilin edhe mund t’jua lexoj nëse është e nevojshme. Ai ka sugjeruar që të jetë pjesë e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale.

Në fillim, qëndrimi ynë ka qenë që te neni 58 “Për viktimën”, të kishte një përkufizim.

U tha që është e qartë se çfarë nënkupton viktima, sepse kemi bërë një dispozitë tranzitore në fund, ku kemi thënë se termi “i kërkuar” dhe “i dëmtuar akuzues” të zëvendësohet me konceptin “viktimë” dhe “viktimë akuzuese”. Sipas ekspertëve është menduar që kjo të konsiderohet si e ezauruar, por nëse ka nevojë për të pasur një përkufizim të “viktimës” dhe të “viktimës akuzuese”, ajo është e njëjtë me konceptin e të “dëmtuarit” dhe të “dëmtuarit akuzues”.

Nëse ka nevojë të qartësohet, e bëjmë, por ne kemi menduar që kjo çështje është e zgjidhur me dispozitën tranzitore. Përkufizimin e kemi. Pra, nëse do biem dakord që të ketë një përkufizim të viktimës, atë e ka sjellë OPDAT-i.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Rama - Më fal, zoti kryetar!

Nuk e di se çfarë propozimi ka sjellë OPDAT-i, por unë di (dhe këtë e them me kompetencë) që në shqip fjala “viktimë” dhe fjala “i dëmtuar” nuk kanë të njëjtin kuptim.

Fjala “viktimë” dhe fjala “i dëmtuar”, “viktimë akuzuese” dhe “i dëmtuar akuzues” nuk kanë të njëjtin kuptim në shqip dhe ne nuk mund të mos e respektojmë këtë normë të gjuhës shqipe. Kjo është arsyeja që unë insisto.

Po e përsëris edhe një herë, që në seancat gjyqësore, në diskutime, si dhe në seancat dëgjimore që janë bërë dhe që ju i keni ndjekur, gjyqtarët dhe prokurorët janë shprehur kundër termit “viktimë”, sepse thonë që nuk mund t’i drejtohen në sallën e gjyqit me termin “viktimë” një njeriu që është “i dëmtuar”.

Në këtë kuptim e kam edhe unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po. Pas saj zonja Bumçi, ose zoti Smibert.

Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, termi “viktimë” ka hyrë qysh në vitin 1985, në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, dhe aty jepet përkufizimi se kush quhet viktimë: “Viktimë është një person, ose një grup personash që ka pësuar një dëm fizik, moral, shpirtëror, apo psikologjik për shkaqe të ndryshme”.

Në të gjitha konventat përdoret termi “viktimë”.

Luan Rama – Në anglisht.

Vasilika Hysi – Jo. Edhe në konventat e ...

Luan Rama – Në anglisht ka atë kuptim që thatë ju.

Vasilika Hysi – Më falni!

Të gjitha konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë e kanë përkthyer termin “viktimë” dhe ne jemi të detyruar ta përafrojmë legjislacionin sipas konventave. Nëse Ministria e Drejtësisë, qysh nga '98-a që është miratuar Kushtetuta dhe deri sot, nuk e di që ka një Fjalor të Gjuhës Shqipe ku termi “ viktimë”...

Tani që e lexuat, mua po më duket pak qesharake, sepse “viktima” nuk mund të quhet e tillë vetëm nga tërmeti dhe nga aksidentet. Dëmi sot nuk është vetëm fizik dhe jetësor, por është edhe psikologjik, emocional, dëm seksual etj. Pra, është shumë më e gjerë se kaq.

Me të drejtë, zoti Rama tha se gjyqtarët dhe prokurorët e kanë kundërshtuar këtë term. Po, e kanë kundërshtuar. Kjo është një reformë e madhe, është një reformë jo vetëm në ligje, por edhe në mentalitet.

Vite më parë, një punonjës i policisë apo një prokuror, nuk e konceptonte dot që t'i jepte Deklaratën e të Drejtave një qytetari.

Luan Rama - Kjo është propagandë.

Vasilika Hysi - Jo, nuk është propagandë.

“Nuk e kam në ligj”- thoshte ai, megjithëse ishte në konventë. Prandaj u detyruam që në Kodin e Procedurës Penale, të parashikonim Deklaratën e të Drejtave, sikurse e bëmë edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Ne kemi ende gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë që nuk e dinë se konventa qëndron mbi ligjin dhe në rast se nuk është në Kodin e Procedurës Penale, ata duhet të zbatojnë direkt Konventën për të Drejtat e Fëmijëve ose Konventën për Parandalimin e Torturës etj.

E treta që do doja të theksoja : është e vërtetë që në realitetin shqiptar fjala “viktimë” ka konotacion negativ, por ne nuk do merremi me zhargonet, apo me...

Luan Rama – Nuk ka vetëm konotacion negativ. Të thuash “viktimë” për një të vrarë, nuk është konotacion negativ.

Vasilika Hysi – Më fal!

Ta mbaroj, zoti Rama!

Luan Rama – Nuk është konotacion negativ, po keqpërdoret ajo që thashë.

Vasilika Hysi – Ja, ta mbaroj!

Luan Rama – “Viktimë” nuk ka vetëm konotacion negativ, “viktimë” në shqip do të thotë edhe një i vrarë apo një i vdekur. Konotacioni negativ i termit “viktimë” është kur bëhet fjalë për një njeri, të cilin do ta personifikosh si të mbaruar dhe të lënë në gjendje të mjeruar.

Insistoj edhe një herë, unë e kuptoj rëndësinë dhe prioritetin që ka konventa ndërkombëtare para çdo ligji në Shqipëri, por në shqip “viktimë” dhe “i dëmtuar” nuk janë e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Kam përshtypjen se tani nuk e zgjidhim dot, sepse kemi bërë 300 nene.

Nga pikëpamja gjuhësore, logjika që përdor zoti Rama dhe po të lexosh fjalorin, edhe për mua ashtu është.

A t’ia lëmë detyrë ministrisë, kur të bëjë kodin e ri?

Luan Rama – Nuk po bëhem pengesë, por po them që ka një ndjeshmëri qytetare për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë jam dakord që koncepti në shqip mund të tingëllojë...

Të lutem!

Vasilika Hysi – A ta mbaroj pak?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kam mbaruar fjalën.

Në këtë kuadër detyra e komisionit ...

Fatmir Xhafaj – E di se përse? Ti fillon bën histori dhe...

Vasilika Hysi – Jo, nuk bëj fare histori!

Zoti kryetar, duhet të mësohemi që kur të hartojmë ligjet në komision, duhet të kemi parasysh edhe ato konventa që kemi kaluar në komision dhe ...

Fatmir Xhafaj – Askush nuk po thotë që...

Vasilika Hysi – ... terminologjia që do të përdorim duhet të jetë e njëjtë dhe nëse nuk jemi dakord me një sërë termash, ndjesë! Kur të vijnë konventat duhet t’i shikojmë dhe t’ia kthejmë përkthimit zyrtar dhe ti themi që nuk e keni përkthyer zyrtarisht.

Unë pajtohem me shqetësimin që ngriti zoti Rama.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, pra t’u japim kohë atyre që kur të bëjnë...

Vasilika Hysi – Përse të mos shohin Fjalorin e Gjuhës Shqipe, që është i vjetër dhe që ka nevojë të rishikohet?

Faleminderit!

Luan Rama – Nuk është i vjetër, zonja Vasilika!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Rama – Më falni! Një sekondë, ju lutem!

Zonja Vasilika, ju lutem!

Fjalori i Gjuhës Shqipe nuk është i vjetër. Ai apdejtohet në mënyrë të vazhdueshme dhe dinamike. Më lejo të të shpjegoj që gjuha është një organizëm i gjallë dhe se ky fjalor pasurohet ditë pas dite. Është varianti i 2011-ës, i 2012-ës, i 2013-ës dhe për sa kohë që një ligj i drejtohet auditorit të qytetarëve shqiptarë, atëherë duhet respektuar norma gjuhësore e gjuhës shqipe.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë jam dakord me propozimin që ka bërë OPDAT-i.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Vasilika Hysi – Në Kodin e Procedurës Penale kemi përkufizimin, “ i dëmtuar”, “i akuzuar” etj. Le ta lëmë si përkufizim, sa të mësohen me këto.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ministria ka një koment.

Dashamir Peza – Zoti kryetar, kam një koment: e para ne nuk jemi Kongresi i Drejtshkrimit, por jemi Komision Ligjesh.

Fatmir Xhafaj – Këtu nuk bie fare dakord!

Dashamir Peza – Ne ...

Fatmir Xhafaj – Kur shkruhet një ligj, shkruhet shqip, i dashur!

Dashamir Peza – Ne jemi Komision Ligjesh dhe e shkruajmë shqip, por nuk jemi Kongresi i Drejtshkrimit që të ndryshojmë kuptimin e fjalëve dhe të duam t’i japim ne kuptim fjalëve.

Fatmir Xhafaj – Nuk po e kërkon njeri këtë!

Dashamir Peza – Fjala që përdoret ka po atë kuptim që është shkruar edhe në fjalor, nuk mund të ketë kuptim tjetër.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Dashamir Peza – Ne nuk kemi të drejtë t’i japim një fjale një kuptim, të cilin nuk e ka në Fjalorin e Gjuhës Shqipe.

Fatmir Xhafaj – Unë ju kuptoj edhe ju, edhe zotin Rama, por keni një zgjidhje sot, ju?

Dashamir Peza – Zgjidhja që kemi është kjo, që për sa i përket çështjes së përdorimit të fjalës ne jemi të detyruar të hapim fjalorin dhe të shohim kuptimin që ka në gjuhën shqipe. Kjo mua më duket e detyrueshme. Është obligatore, nuk është një gjë të cilën e zgjedhim ose jo.

Është çështje tjetër se si e zgjidhim problemin!

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

A ka ministria ndonjë koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Nuk jeni të gjithë ekspertë të Fjalorit të Gjuhës Shqipe!

Kam shumë respekt për gjithë ekspertizën tuaj penale si prokuror. Doni, s’doni ju apo unë, ai është.

Ulsi Manja – Nuk e kam për gjuhën shqipe, zoti kryetar. E votuam nenin 282 të këtij projekti dhe këtu është shumë e zgjidhur çështja.

Fatmir Xhafaj – Të lutem, a mund ta futni përkufizimin e termit “viktimë”, sipas propozimit që keni nga OPDAT-i! A e keni problem?

Ulsi Manja – Po, sepse do të na bënte të ndryshonim nenin 282.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Hoxha!

Artan Hoxha – Për këtë përdorimin e termit kemi pasur shumë debat. Edhe atë që thotë zoti Rama e kam pasur unë me kohë. Por, meqenëse duhet të ndjekim terminologjitë e standardeve, ne nuk kemi rrezikuar të bëjmë definicionin, sepse pastaj do të hymë në ..., por kemi thënë, me dispozitën që tha deputeti, me nenin 282, kemi thënë se “i dëmtuari akuzues” zëvendësohet me “viktimën” dhe “viktimën akuzuese”, që do të thotë se koncepti i viktimës sipas Kodit të Procedurës Penale është në atë kuptim që i ka dhënë ky kod dhe të drejtat dhe detyrimet që ai ka. Kjo do të thotë se më këtë zgjidhet një situatë që është gjuhësore edhe konceptuale.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Luan Rama – Kjo nxjerr një problem, që duhet pasur parasysh në proces, që në grupet e punës duhet domosdoshmërisht të jetë edhe një përfaqësues nga Akademia e Shkencave, nga Instituti i Gjuhësisë për të ruajtur edhe koherencën gjuhësore të akteve që shqyrtohen dhe

miratohen, sepse në gjuhën shqipe kanë fituar qytetari shumë terma ndërkombëtarë dhe janë bërë të shqipes, ndërkohë që ka terma të tjera që janë pjesërisht të bëra familjare në gjuhën shqipe, siç është edhe rasti i termit “viktimë”.

Kështu që për të shmangur çdo lloj keqkuptimi, do të ishte mirë, zoti kryetar, që në procese të kësaj natyre duhet të jetë në përbërje të grupit të punës, detyrimisht, edhe një punonjës shkencor i gjuhës shqipe për ta normuar gjuhën e akteve sa është e mundur me normën gjuhësore letrare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Unë jam shumë dakord me këtë edhe për një gjë tjetër. Ju e dini të gjithë se sa kemi vuajtur ne me Kushtetutën për këtë gjë, sepse kishim shumë probleme. Kemi marrë redaktorin e Kushtetutës së vitit 1998 dhe kemi qenë shumë të lumtur atë ditë që e kemi gjetur dhe që ka ardhur këtu të punojë, ndryshe rrezikonim që të kishim në Kushtetutë shumë gabime, për shkak se ne nuk jemi përdorues të mirë të gjuhës shqipe. Nga kjo pikëpamje unë besoj se e para këtë gjë duhet ta ketë Ministria...

Bledar Dervishaj – Në strukturën tonë të punës, të paktën në hartimin e akteve, në Ministrinë e Drejtësisë kemi modelin e kodifikimit, që është përgjegjës për hartimin e normës dhe përcjelljen e saj sa më mirë tek ai që do ta zbatojë. Pas hartimit kalon në një sektor tjetër që wshtw reduktimi gjuhësor, si cili është i specializuar vetëm për ligjet.

Fatmir Xhafaj – E ka edhe Kuvendi, por Kuvendi e bën këtë zakonisht pasi votohet në Parlament...

Bledar Dervishaj - ... dhe kthimi pas, se ndodh nganjëherë që shqipërimi i normës ia ndryshon konotacionin ekspertit dhe rikthehet për t’u punuar bashkë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Lidhur me shqetësimin që ka zoti Rama për mënyrën si mund të thirren palët. Ka një gjë, zoti Kryetar, në praktikën gjyqësore nuk mund t’i thuhet të pandehurit “çohu i pandehur”. I pandehuri është zoti x apo y. Viktimës nuk i thuhet viktimë, por i thuhet zoti, zonja. Ne kemi një problem në komunikimin me njerëzit. U themi “i pandehur”, ndërkohë që ai ka një emër.

Ia mora zonjës Bumçi këtë diskutim, sepse kishte ndër mend ta bënte ajo. Ndjesë!

Ne kemi në diskutim ligjin “Për ndihmën juridike” dhe zoti Majko është relatori. Unë dje ngrita disa shqetësime...

Fatmir Xhafaj – Po pra, ramë dakord dje që të bëhet sipas ligjit.

Pandeli Majko – Në këtë atmosferë liberale besoj se ekspertët do të na mirëkuptojnë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A ka gjë tjetër që ta mbyllim Kodin e Procedurës Penale?

Luan Rama – Përveç falënderimit për punën shumë të mirë të bërë nga të gjithë ekspertët, e huaj dhe vendas, dua të bëj një falënderim të veçantë për ju si kryetar i komisionit që keni drejtuar këtë proces me kaq vështirësi dhe me kaq komplikacione duke e kurorëzuar me sukses.

Fatmir Xhafaj – Tani më latë pa fjalë, se mendova se kushedi çfarë do të thotë dhe hajde si ta zgjidh...

Kush është dakord në tërësi me Kodin e Procedurës Penale?

Faleminderit!

Henrik Ligori – Në qoftë se ju kujtohet, dje kishim një mosdakordësi për një term, për të çuar çështjen në gjyq, thamë “prova të mjaftueshme që mbështesin akuzën”. Kishim një diskutim me përfaqësuesit e OPDAT-it dhe ne ramë dakord që të bënim një modifikim dhe të shtonim një fjali që këto prova me të cilat shkon çështja në gjyq nuk do të thonë se i pandehuri është fajtor.

Fatmir Xhafaj – Po pra, e thamë që dje atë dhe quhet e mirëqenë. Po sa për ta saktësuar, dakord. U saktësua edhe kjo.

Edhe një herë, meqenëse u saktësua edhe kjo gjë, kush është dakord me Kodin e Procedurës Penale? Votimi në tërësi.

Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Faleminderit, të gjithë kolegëve!

Një falënderim i veçantë për dy relatorët zotin Muçmataj dhe zoti Manja që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme. Një falënderim i veçantë për zotin Hoxha, zotin Ligori, zonjën Bumçi dhe për zotin Smajder dhe gjithë ekipin që kanë punuar me ta për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, për zonjën që është lodhur duke përkthyer dhe, padyshim, për Mozën dhe grupin e ekspertëve të sekretariatit teknik që kanë qenë fantastikë dhe jam shumë i lumtur që kam pasur mundësinë të punoj me ta.

Faleminderit!

E mbyllim këtu. Për Kodin e Procedurës Penale dhe ndoshta do të keni një njoftim për nesër për dy ligjet e tjera me shumicë të cilësuar.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA